# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 43

**Tiranë – E mërkurë, 23 mars 2016**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret i Presidentit nr. 9459, datë 8.3.2016 | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare........................................ | 2989 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 9.3.2016 | Për autorizimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës për lidhjen e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe studios konsulente "Roland Berger"................................................................ | 2989 |
| Udhëzim i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 3, datë 8.3.2016 | Mbi praktikat e mira të prodhimit për materiale dhe artikuj që mendohet të jenë në kontakt me ushqimin...................................... | 2990 |
| Urdhër i ministrit të Financave nr. 36, datë 8.3.2016 | Për shpalljen e disa ndryshimeve në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyera në gjuhën shqipe......................................................................................... | 2992 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 26, datë 9.3.2016 | Për miratimin e kërkesës së KESH sh.a., për shtyrjen e afatit të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike midis KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015... | 2994 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 9.3.2016 | Për miratimin e marrëveshjes për furnizimin me energji elektrike midis KESH sh.a./FPSH dhe OSHEE sh.a./FPP.......................... | 2994 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 28, datë 9.3.2016 | Mbi kërkesën e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 16.2.2016, të Bordit të ERE-s, mbi tarifën fikse të energjisë, që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016.............................................................................................. | 2996 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 29, datë 9.3.2016 | Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Ballenja Power Martanesh"sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Ballenja", me fuqi të instaluar 1900 kw.......... | 2996 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 30, datë 9.3.2016 | Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.................................................................................................... | 2997 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 31, datë 9.3.2016 | Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.................................................................................................... | 2997 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 9.3.2016 | Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Skatina HEC" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Skatina", me fuqi të instaluar 2677 kw......................... | 2998 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 9.3.2016 | Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Phoenix Petroleum" sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror........... | 2999 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 34, datë 9.3.2016 | Për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit".......................................................................................... | 2999 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 35, datë 9.3.2016 | Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike...... | 2999 |
| Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 11, datë 23.2.2016 | Për një ndryshim në vendimin nr. 23, datë 24.6.2015, "Për licencimin Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a."............................ | 3000 |
| Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 12, datë 23.2.2016 | Për një ndryshim në vendimin nr. 26, datë 22.12.2014, "Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës Ura Vajgurore"................................ | 3000 |
| Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 13, datë 23.2.2016 | Për licencimin e operatorëve dhe miratimin e tarifave të shërbimit UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit të shoqërive UK........................................................................................ | 3000 |
| Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 906/1, datë 9.3.2016 | Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "ByPass-Vlorë (shtesa)" (faza e parë), për pasuritë e llojit: "objekt", "truall", "arë", "kullotë", "ullishte"..................................................................... | 3001 |
| Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1328, datë 15.3.2016 | Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Përmirësimi i shtresave rrugore Fushë-Krujë - Thumanë".......... | 3005 |

**DEKRET**
**Nr. 9459, datë 8.3.2016**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Varvara Jorgji Babasikas
2. Valbona Ylli Kodra (Hysaj)
3. Arian Zef Dema
4. Drini Ali Salihi
5. Nertila Laz Krasniç (Kondakçiu)
6. Bujamin Nuredin Qahalliu
7. Loreta Lili Marku (Qahalliu)
8. Nazmi Hamdi Tepshi
9. Xhulia Nazmi Tepshi
10. Agime Zenun Bytyqi (Ndreu)
11. Tesela Myzafer Tahiri (Coraj)
12. Enea Irakli Thanasi
13. Teuta Vehip Muharemi (Dajaka)
14. Ervis Luan Paja
15. Vladimir Gligo Šunjević (Prandvera)
16. Sfetkllanka Niko Ajkoviq (Matanoviq)
17. Aleksandër Gjok Preka
18. Gerta Xhevahir Lesjak (Braçe)
19. Vladimir Llabut Radusinoviq (Dritarja)
20. Age Ndrec Berisha (Zefi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Bujar Nishani**

**VENDIM**
**Nr. 198, datë 9.3.2016**

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS PËR LIDHJEN E KONTRATËS NDËRMJET SHTETIT SHQIPTAR DHE STUDIOS KONSULENTE "ROLAND BERGER"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7, 5, pika 1, shkronja "b", 12, pikat 2 e 6, 15, pika 8, e 18, pika 2, të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës si organin e administratës publike të interesuar për lidhjen e kontratës me studion konsulente "Roland Berger".

2. Autorizohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për lidhjen e kontratës me studion konsulente "Roland Berger".

3. Studioja konsulente "Roland Berger" do të zhvillojë një kuadër ligjor, kontraktual dhe bashkëpunimi në nivele kombëtare e ndërkombëtare, së bashku me një vlerësim paraprak për 3-4 projektpropozime të infrastrukturës së transportit, të cilësisë së lartë, tërësisht të vlerësuara e të përshtatshme për përpunim të mëtejshëm, në propozime për t'u investuar. Në këtë kuadër, për realizimin e këtij qëllimi, detyrat e konsulentit do të përfshijnë, pa u kufizuar në:

- analizë të kuadrit ligjor shqiptar dhe rajonal, që rregullon investimet e huaja dhe projektet ndërkufitare, analizë të hollësishme të detyrimeve të secilës pale, në projektet ndërqeveritare, dhe sigurim të rekomandimeve/vlerësimeve përkatëse, për zhvillim të suksesshëm të tyre;
- analizë të alokimit së riskut për secilin projekt, duke bërë edhe vlerësim sasior të risqeve të alokuara për palën shqiptare, dhe sigurim të rekomandimeve/vlerësimeve përkatëse;
- analizë të projekteve prioritare në sektorin e transportit, në veçanti, projektet me rëndësi strategjike, vlerësim të fizibilitetit të lartë teknik, impaktit ekonomik e social, potencialit tregtar dhe qëndrueshmërisë ekonomike, duke marrë në

konsideratë si investimet private ashtu edhe mbështetjen financiare publike;

- vlerësim të detajuar të propozimeve ekzistuese financiare, nga sektori privat, të cilat mund të plotësojnë projektlistën prioritare;

- vlerësim të situatës ekzistuese dhe përgatitje të strategjisë për negocimin e kontratave të mundshme;

- identifikim dhe vlerësim të projekteve kyçe, hartim dhe zhvillim të strategjisë përkatëse, për t'u zbatuar deri në realizimin e fazës përfundimtare, të propozimeve për t'u invenstuar, duke përfshirë, ndër të tjera, edhe përgatitjen e dosjeve të projektpropozimeve, përmbledhjen e projektit, përshkrimin e karakteristikave kyçe, gjetjet më të rëndësishme të ushtrimeve të vlefshme e analizave të kryera dhe çdo gjë tjetër që mund të jetë e nevojshme për mundësimin e realizimit përfundimtar të këtyre propozimeve për investime;

- hartim, zhvillim dhe paraqitje të rekomandimeve strategjike në instancat më të larta të qeverisë shqiptare, me qëllim sigurimin e asistencës dhe ekspertizës së nevojshme, në kuadër të vendimmarrjes për përzgjedhjen e 3–4 projekteve kryesore;

- sigurim të asistencës e ekspertizës së nevojshme për koordinim dhe bashkëpunim në nivel politik, ndërmjet qeverisë shqiptare dhe qeverive të shteteve të Ballkanit Perëndimor, për bashkëpunimin në zonat kufitare strategjike, për projektet e transportit;

- sigurim të mbështetjes së nevojshme, në lidhje me realizimin e bashkëpunimit ndërmjet shtetit shqiptar dhe vendimmarrësve kryesorë të Bashkimit Evropian, me secilin shtet të Bashkimit Evropian, veçanërisht me Republikën Federale të Gjermanisë, ashtu si edhe me çdo donator e partner publik të huaj, të mundshëm, me qëllim gjetjen e financimit për projektet e cilësuara si prioritare;

- sigurim të çdo asistence dhe ekspertize që mund të rezultojë e nevojshme në realizimin e plotë të kuadrit të përcaktuar në pikën 3 më lart;

- kryerje të çdo veprimi dhe të ofrim të çdo shërbimi tjetër të arsyeshëm, me qëllim asistimin e MTI-së në zhvillimin e procesit të propozimeve që do paraqiten, sikurse është specifikuar më lart;

- kërkim të të gjitha autorizimeve apo aktpërfaqësimeve të nevojshme për realizimin e shërbimit;

- raportim me shkrim për veprimet dhe procedurat e ndërmarra, sa herë t'i kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, nga MTI-ja.

4. Kohëzgjatja e kësaj kontrate do jetë 6 (gjashtë) muaj.

5. Vlera e kësaj kontrate do të jetë 480 000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) euro, pa TVSH, e cila do të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.

6. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

## UDHËZIM
## Nr. 3, datë 8.3.2016

## MBI PRAKTIKAT E MIRA TË PRODHIMIT PËR MATERIALE DHE ARTIKUJ QË MENDOHET TË JENË NË KONTAKT ME USHQIMIN[1]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 41, pika 12, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton rregullat mbi praktikat e mira të prodhimit (PMP) për grupet e materialeve dhe artikujve që mendohet të jenë në kontakt me ushqimin (këtej e tutje të referuara si materiale dhe artikuj), të listuara në shtojcën 1, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, "Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet", dhe kombinimet e materialeve dhe artikujve ose materialeve dhe artikujve të ricikluar, të përdorur në to.

2. Ky udhëzim do të aplikohet në të gjithë sektorët dhe në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së materialeve dhe

[1] Ky udhëzim është përafruar plotësisht me: Rregulloren e Komisionit nr. 2023/2006, e 22 dhjetorit 2006, "Mbi praktikat e mira të prodhimit për materiale dhe artikuj që mendohet të jenë në kontakt me ushqimin", amenduar me Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 282/2008 e 27 marsit 2008 CELEX 2006R2023— EN Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 384, datë 29.12.2006, faqe 75.

artikujve, duke përjashtuar prodhimin e substancave fillestare.

Rregullat e detajuara të përcaktuara në shtojcë do të aplikohen në proceset përkatëse individuale të përmendura, sipas rastit.

3. Për qëllime të këtij udhëzimi do të aplikohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "Praktika të mira prodhimi" (GMP) nënkupton ato aspekte të sigurimit të cilësisë, të cilat sigurojnë që materialet dhe artikujt janë prodhuar në mënyrë të vazhduar dhe të kontrolluar për të siguruar konformitetin me rregullat e zbatueshme për ta dhe me standardet e cilësisë, të përshtatshme me përdorimin e tyre të synuar, duke mos vënë kështu në rrezik shëndetin e njeriut ose duke shkaktuar një ndryshim të papranueshëm në përbërjen e ushqimit ose një përkeqësim në karakteristikat organoleptike të tyre;

b) "Sistemi i sigurimit të cilësisë" nënkupton shumën totale të përgatitjeve (aranzhimeve) të rregullta dhe të dokumentuara, të bëra me qëllim që të sigurojnë që materialet dhe artikujt të kenë cilësinë e kërkuar për të garantuar përshtatje me rregullat që aplikohen mbi to dhe standardet e cilësisë të nevojshme për përdorimin e synuar të tyre;

c) "Sistemi i kontrollit të cilësisë" nënkupton aplikimin sistematik të masave të vendosura brenda sistemit të sigurimit të cilësisë, që sigurojnë pajtueshmëri të materialeve dhe artikujve fillestarë, të ndërmjetëm dhe final me specifikimet e caktuara në sistemin e sigurimit të cilësisë:

d) "Ana jo në kontakt me ushqimin" nënkupton sipërfaqen e materialit ose artikullit i cili nuk është në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin:

e) "Ana në kontakt me ushqimin" nënkupton sipërfaqen e materialit ose artikullit, i cili është në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin.

4. Operatori i biznesit do të sigurojë që operacionet e prodhimit të jenë kryer në përputhje me:

a) rregullat e përgjithshme mbi PMP-në, siç parashikohen më poshtë;

b) rregullat e detajuara mbi PMP-në, siç përcaktohen në shtojcë.

5. Operatori i biznesit do të vendosë, implementojë dhe sigurojë respektimin e një sistemi efektiv dhe të dokumentuar të sigurisë së cilësisë. Ky sistem do të:

a) marrë parasysh përshtatshmërinë e personelit, njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe organizimin e ambienteve dhe pajisjeve të nevojshme për të siguruar që materialet dhe artikujt e gatshëm janë në përputhje me rregullat e zbatuara mbi to;

b) zbatohet duke marrë parasysh përmasat e biznesit të drejtuar nga operatori, në mënyrë që të mos jetë një ngarkesë e tepruar për biznesin.

6. Materialet fillestare do të përzgjidhen dhe përshtaten me specifikimet e paracaktuara që do të sigurojnë pajtueshmëri të materialit ose artikullit me rregullat e zbatuara mbi to.

7. Operacionet e ndryshme do të kryhen në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e paracaktuara.

8. Operatori i biznesit do të vendosë dhe mirëmbajë një sistem efektiv të kontrollit të cilësisë.

9. Sistemi i kontrollit të cilësisë do të përfshijë monitorimin e implementimit dhe kryerjen e PMP-së dhe do të identifikojë masat për të korrigjuar çdo dështim në kryerjen e PMP-së. Këto masa korrigjuese do të implementohen pa vonesa dhe do të jenë të gatshme për autoritetet përkatëse për inspektim.

10. Operatori i biznesit do të krijojë dhe mbajë dokumentacionin e përshtatshëm në letër ose në format elektronik, në lidhje me specifikimet, formulat dhe proceset e prodhimit, të cilat janë të rëndësishme për pajtueshmërinë dhe sigurinë e materialit ose artikullit të përfunduar.

11. Operatori i biznesit do të krijojë dhe mbajë dokumentacionin e përshtatshëm në letër ose në format elektronik, në lidhje me të dhënat që mbulojnë operacione të ndryshme të prodhimit të cilat janë të rëndësishme për pajtueshmërinë dhe sigurinë e materialit ose artikullit të përfunduar (final) dhe në lidhje me rezultatet e sistemit të kontrollit të cilësisë.

12. Dokumentacioni do të vihet në dispozicion nga operatori i biznesit, autoriteteve kompetente me kërkesë të tyre.

13. Ngarkohet Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
**Edmond Panariti**

SHTOJCA
RREGULLAT E DETAJUARA MBI PRAKTIKAT E MIRA TË PRODHIMIT

**A. Bojërat e printimit**

Proceset që përfshijnë aplikimin e bojërave të printimit në materialet ose artikujt në anën jo në kontakt me ushqimin

1. Bojërat e printimit të aplikuara në materialet dhe artikujt në anën jo në kontakt me ushqimin do të formulohen dhe/ose aplikohen në mënyrë të tillë që substancat nga sipërfaqja e shtypur nuk kalojnë në anën në kontakt me ushqimin:

a) nëpërmjet substratit; ose

b) nga zbukurimi në rafte ose mbështjellja,

në përqendrime që çojnë në nivelet e substancës në ushqim që nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit 3, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, "Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet".

2. Materialet dhe artikujt e shtypura duhet të trajtohen dhe ruhen në formën e tyre të gatshme dhe gjysmë-të gatshme në mënyrë të tillë që substancat nga sipërfaqja e shtypur nuk janë transferuar në anën në kontakt me ushqimin:

a) nëpërmjet substratit; ose

b) nga zbukurimi në rafte ose mbështjellja,

në përqendrime që çojnë në nivelet e substancës në ushqim që nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit 3, të udhëzimit nr. 15, datë 13.12.2012, "Mbi materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet".

3. Sipërfaqet e shtypura nuk do të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me ushqimin.

**B. Sistemi i sigurimit të cilësisë për proceset e riciklimit të plastikës, mbi materialet dhe artikujt plastikë të riciklueshëm që mendohet të jenë në kontakt me ushqimin**

1. Sistemi i sigurimit të cilësisë zbatuar nga ricikluesi duhet të japë besimin e mjaftueshëm në aftësinë e procesit të riciklimit për të siguruar që plastika e ricikluar plotëson kërkesat në autorizim.

2. Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga ricikluesi për sistemin e tij të sigurimit të cilësisë, duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e deklaratave dhe procedurave të shkruara.

Dokumentacioni i sistemit të cilësisë duhet të lejojë interpretim uniform të politikave dhe procedurave të cilësisë, të tilla si programet, planet, manualet, të dhënat e cilësisë dhe masat e marra për të siguruar gjurmueshmërinë.

Ajo duhet të përfshijë, në veçanti:

a) një manual të politikave të cilësisë, që përmban një përkufizim të qartë të objektivave të cilësisë nga ricikluesi, organizimin e biznesit dhe në veçanti strukturat organizative, përgjegjësitë e stafit drejtues (menaxherial) dhe autoritetin organizativ të tyre, që ka lidhje me prodhimin e plastikeve të riciklueshme;

b) planet e kontrollit të cilësisë, duke përfshirë të dhënat dhe karakteristikat e plastikeve të riciklueshme, kualifikimin e furnizuesit, procese klasifikimi, proceset e larjes, proceset e pastrimit të thellë, proceset e ngrohjes, apo çdo pjesë tjetër e procesit që lidhet me cilësinë e plastikeve të riciklueshme, duke përfshirë këtu zgjedhjen e pikave të cilat janë kritike për kontrollin e cilësisë së plastikeve të ricikluara;

c) menaxhimi dhe procedurat operative të zbatuara për të monitoruar dhe kontrolluar të gjithë procesin e riciklimit, duke përfshirë edhe inspektimin dhe teknikat e sigurimit të cilësisë në të gjitha fazat e prodhimit, veçanërisht vendosja e kufijve kritikë në pikat, të cilat janë kritike për cilësinë e plastikës së ricikluar;

d) metodat e monitorimit, funksionimin efikas të sistemit të cilësisë dhe, në veçanti, aftësia e saj për të arritur cilësinë e dëshiruar të plastikës së ricikluar, duke përfshirë kontrollin e produkteve të cilat nuk arrijnë të jenë në përputhje;

d) testet dhe protokollet analitike ose ndonjë provë tjetër shkencore të aplikuar para, gjatë dhe pas prodhimit të plastikës së ricikluar, frekuenca me të cilën ato do të zhvillohen, si dhe pajisjet e testimit të përdorura; ajo duhet të jetë në mënyrë adekuate e mundur të ndjek përsëri kalibrimin e pajisjeve të testit;

f) dokumentet e regjistrimit të miratuara.

**URDHËR**
**Nr. 36, datë 8.3.2016**

**PËR SHPALLJEN E DISA NDRYSHIMEVE NË STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT DHE TË RAPORTIMIT FINANCIAR, TË PËRKTHYERA NË GJUHËN SHQIPE**

Në mbështetje të nenit 4, të pikës 3, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, të vendimit nr. 2,

datë 24.2.2016, të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, "Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve të ndodhura për SNRF-të dhe SNK-të gjatë vitit 2015", të cilat hyjnë në zbatim pas datës 1 janar 2016.

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) si më poshtë:

| Titulli | Data efektive |
|---|---|
| Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 | Pas 1 janarit 2016 |

2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
**Arben Ahmetaj**

# Data efektive e ndryshimeve të SNRF 10 dhe SNK 28

## Ndryshime në SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*

Në shtojcën C është ndryshuar paragrafi C1C. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

## Data e hyrjes në fuqi

...

C1C *Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse* (Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28), i publikuar në Shtator 2014, ndryshoi paragrafët 25–26 dhe shtoi paragrafin B99A. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për transaksione që ndodhin në periudhat vjetore që fillojnë ~~më 1 Janar 2016~~ e në vijim, data do të përcaktohet nga BSNK. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

## Ndryshimet në SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta*

Është ndryshuar paragrafi 45C. Teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

## Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

45C *Shitja ose Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe Pjesëmarrjes ose Sipërmarrjes së Përbashkët përkatëse* (Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28), i publikuar në Shtator 2014, ndryshoi paragrafët 28 dhe 30 dhe shtoi paragrafët 31A–31B. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për transaksione që ndodhin në periudhat vjetore që fillojnë ~~më 1 Janar 2016~~ e në vijim, data do të përcaktohet nga BSNK. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

**VENDIM**
**Nr. 26, datë 9.3.2016**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË KESH SHA PËR SHTYRJEN E AFATIT TË MARRËVESHJES PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS KESH SHA DHE OSHEE SHA PËR TEPRICAT E ENERGJISË ELEKTRIKE, PËRFSHIRË TEPRICAT NË KUSHTET E PRURJEVE TË MËDHA, ME QËLLIM PLOTËSIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 16, 108, 109, pika 5, 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, pasi u njoh me kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për miratimin e amendimit të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike midis KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015, si dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi se:

- KESH sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 10, datë 6.2.2014.
- OSHEE sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014.
- KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë lidhur në datën 6.2.2015, marrëveshjen për shitblerjen e energjisë elektrike midis KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015.
- Palët kanë nënshkruar bashkërisht amendimin e nenit 7 të marrëveshjes, për shtyrjen e afatit të saj deri më 30.6.2016.
- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", hidhen bazat për krijimin e një modeli të ri të tregut të energjisë elektrike dhe marrëdhënieve që do të vendosen midis pjesëmarrësve në këtë treg dhe në sektorin elektroenergjitik. Ky ligj parashikon një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatore që duhet të miratohen (përcaktim i nenit 108) brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi, për të siguruar zbatimin e plotë të tij; po ashtu në kuptim të nenit 109, pika 5, detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut do të vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike midis KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015, deri më 30.6.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të licencuarit KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2016 – 30 qershor 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 27, datë 9.3.2016**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE MIDIS KESH SHA/FPSH DHE OSHEE SHA/FPP**

Në mbështetje të nenit 16, 20 germa "h", 108, 110 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" pikat 4; 14, germa "A", pika 2 dhe pika 7, germa "f", të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr. 338, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, kapitulli V i Rregullave të Tregut Shqiptar, miratuar me vendimit nr. 68, datë 23.6.2008 të ERE-s, i ndryshuar, dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të

datës 9.3.2016, pasi u njoh me kërkesën e shoqërisë KESH sh.a., për miratimin e marrëveshjes për furnizimin me energji elektrike midis KESH sh.a./FPSH dhe OSHEE sh.a./FPP për periudhën 1 janar 2016 – 30 qershor 2016, si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s,

konstatoi se:

- KESH sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 10, datë 6.2.2014.

- OSHEE sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014.

- KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë lidhur në datën 31.12.2014, marrëveshjen për furnizimin me energji elektrike nëpërmjet FPSH/KESH sh.a. dhe FPP/OSHEE sh.a., me afat 1-vjeçar (njëvjeçar), miratuar me vendimin e ERE-s nr. 11, datë 4.2.2015.

- Palët kanë nënshkruar bashkërisht këtë marrëveshje, e cila i shtrin efektet nga data 1 janar 2016 deri në datën 30 qershor 2016.

- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", hidhen bazat për krijimin e një modeli të ri të tregut të energjisë elektrike dhe marrëdhënieve që do të vendosen midis pjesëmarrësve në këtë treg dhe në sektorin elektroenergjitik. Ky ligj parashikon një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatore që duhet të miratohen (përcaktim i nenit 108) brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi, për të siguruar zbatimin e plotë të tij; po ashtu në kuptim të nenit 109, pika 5, detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut do të vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

- Baza ligjore e përdorur nga palët për nënshkrimin e kësaj marrëveshje është e pasaktë:

a) Vendimi nr. 68, datë 23.6.2008, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, "Për miratimin e rregullave të tregut shqiptar", me të gjitha ndryshimet e tij është baza ligjore e saktë që duhet të përdoret. Si rrjedhojë vendimi nr. 10, datë 27.1.2016 "Për një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 28.12.2015, "Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike" nuk duhet të citohet në mënyrë të veçantë.

b) Vendimi i pasqyruar me nr. 58, datë 3.6.2008, i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, duhet të jetë vendimin nr. 97, datë 27.10.2014, "Për licencimin e shoqërisë operatori i shpërndarjes të energjisë elektrike sh.a. në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes për furnizimin me energji elektrike ndërmjet FPSH/KESH sh.a. dhe FPP/OSHEE sh.a., për periudhën 1.1.2016 deri në datën 30.6.2016, me ndryshimet përkatëse në bazën ligjore në përmbajtje të marrëveshjes si më poshtë:

a) Vendimi nr. 10, datë 27.1.2016, "Për një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 28.12.2015, "Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike", duhet të zëvendësohet me vendimin nr. 68, datë 23.6.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, "Për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar", i ndryshuar

b) Vendimi nr. 58, datë 3.6.2008 i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, duhet zëvendësohet me vendimin nr. 97, datë 27.10.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, "Për licencimin e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike sh.a., në aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike".

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2016 – 30 qershor 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 28, datë 9.3.2016**

## MBI KËRKESËN E SHOQATËS SHQIPTARE TË ENERGJISË SË RINOVUESHME PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 13, DATË 16.2.2016, TË BORDIT TË ERE-s, MBI TARIFËN FIKSE TË ENERGJISË, QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 16, pika 3, të "Rregullave të Praktikes dhe Procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi ankimin administrativ të shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme AREA, për vendimin nr. 13, datë 16.2.2016, të Bordit të ERE-s,

konstatoi:

- Shoqata AREA nuk përfaqëson palë interesi, të legjitimuar për të kërkuar rishikimin e një vendimi të Bordit të ERE-s.
- Regjistrimi i hetimit gjyqësor për kundërshtimin e një tjetër vendimi të ERE-s nr. 156, datë 24.12.2015, nuk përbën provë të re, që të çojë Bordin e ERE-s në një vendimmarrje të re.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme AREA, për rishikimin e vendimit nr. 13, datë 16.2.2016, të Bordit të ERE-s, "Mbi tarifën fikse të energjisë , që do t'u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016".
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 29, datë 9.3.2016**

## MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "BALLENJA POWER MARTANESH" SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "BALLENJA", ME FUQI TË INSTALUAR 1900 kw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1, germa "a"; 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC "Ballenja",

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., në

aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Ballenja", me fuqi të instaluar 1900 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 30, datë 9.3.2016

## MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "BALLENJA POWER MARTANESH" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "d" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "g"; 5, pika 2; 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, germat "a", "b" dhe "c") janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 31, datë 9.3.2016

## MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "BALLENJA POWER MARTANESH" SHPK, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "ç" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "f'; 5, pika 1 germa "f'; 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC "Ballenja",

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për

procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Ballenja Power Martanesh" sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike nga HEC "Ballenja".

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 32, datë 9.3.2016

## MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SKATINA HEC" SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "SKATINA", ME FUQI TË INSTALUAR 2677 KW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1, germa "a"; 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa "a" e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Skatina HEC" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC "Skatina",

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Skatina HEC" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3).
- Dokumentacionin teknik dhe grafik (neni 9, pika 4.1.3).
- Lejen nga institucione të tjera (neni 9, pika 4.1.5),

do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Skatina HEC" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Skatine", me fuqi 2677 KW.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 33, datë 9.3.2016**

## PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "PHOENIX PETROLEUM" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 4, pikat 50, 105, 107; nenit 22, pika 2, germa "ç"; nenit 83, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror"; neneve 4, pika 1, germa "ç"; 8, 9, pika 1, germat "a", "b", "c", "d", "e"; pika 2, germa "e" dhe nenin 10, pika 1, të Rregullave dhe Procedurave për Licencimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Licencave në sektorin e gazit natyror, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Phoenix Petroleum" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Phoenix Petroleum" sh.a.,

konstatoi se:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") janë plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 1, germat "d"/"i", "d"/"ii", "d"/"iv", "d"/"v", "d"/"vi") është plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale (neni 9, pika 1, germa "e"/"i", "e"/"ii", "e"/ "iii", "e"/"v", "e"/"vi") janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni specifik për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa "e"/"i") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentet specifike për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa "e"/"ii", "e"/"iii") janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Phoenix Petroleum" sh.a., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.
2. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 34, datë 9.3.2016**

## PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E "RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË ASETEVE NGA TË LICENCUARIT"

Në mbështetje të neneve 16, 44, pika 2 dhe 108, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe neneve 29, pika 2, 116, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", dhe nenit 26, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me "Rregulloren e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit",

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit".
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 35, datë 9.3.2016**

## MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e

energjisë elektrike", nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e "draftlicencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike".

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 11, datë 23.2.2016

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 23, DATË 24.6.2015, "PËR LICENCIMIN UJËSJELLËS-KANALIZIME SHKODËR SHA"

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 23, datë 24.6.2015, "Për licencimin Ujësjellës-Kanalizime Shkodër sh.a.", bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1/a bëhet ndryshimi si më poshtë:

Drejtues ligjor: Mark Molla.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Avni Dervishi**

## VENDIM
## Nr. 12, datë 23.2.2016

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 26, DATË 22.12.2014 "PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS URA VAJGURORE"

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 26, datë 22.12.2014, "Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës Ura Vajgurore" bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Drejtues teknik: Jolanda Gjordeni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
**Avni Dervishi**

## VENDIM
## Nr. 13, datë 23.2.2016

## PËR LICENCIMIN E OPERATORËVE DHE MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT UK DERI NË PËRFUNDIM TË PROCEDURAVE TË RIORGANIZIMIT TË SHOQËRIVE UK

Në zbatim të nenit 14, germat "e" dhe "i", të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, duke pasur në konsideratë periudhën kohore që u nevojitet njësive të qeverisjes vendore dhe shoqërive UK për përfundimin e procedurave të riorganizimit, sipas reformës administrative territoriale,

VENDOSI:

1. Shoqëritë ujësjellës-kanalizime, të cilave u përfundon afati i licencës përpara se të përfundojë riorganizimi i tyre, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", duhet të aplikojnë pranë ERRU-së për rinovimin e licencës ekzistuese.

2. Shoqëritë UK që përfundojnë procedurat e riorganizimit, të aplikojnë brenda tre muajve pranë ERRU-së për pajisjen me licencë të re shërbimi.

3. Shoqëritë UK do të përdorin tarifat e shërbimit UK, të miratuara nga ERRU-ja, për zonën e shërbimit sipas licencës ekzistuese të lëshuar nga ERRU-ja, deri në përfundim të procedurave të riorganizimit.

4. Për zonat e reja të cilat janë në proces të kalimit nën administrim të shoqërive UK, deri në miratimin e tarifave pranë ERRU-së, do të zbatohen tarifat që janë aplikuar në këto zona, përpara përfundimit të reformës territoriale.

5. Brenda tre muajve nga përfundimi i procedurave të riorganizimit, shoqëritë duhet të aplikojnë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave të shërbimit UK.

6. Paraqitja e aplikimit për miratimin e tarifave dhe procedura për miratimin e tyre do të kryen në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura";

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";

Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura".

7. Shoqëritë duhet të marrin masat e nevojshme për përfundimin sa më shpejt të procedurave të riorganizimit dhe pasqyrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të ndryshimeve të statusit juridik dhe zonës së shërbimit.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime.

9. Ndjekin zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat e ERRU-së, sipas përkatësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Avni Dervishi**

## KËRKESË
## Nr. 906/1, datë 9.3.2016

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën, "Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "ByPass-Vlorë (shtesa)" (faza e parë), për pasuritë e llojit "objekt", "truall", "arë", "kullotë", "ullishte".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit: “objekt”, “truall”, “arë”, “kullotë”, “ullishte”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 237 038 644 (dyqind e tridhjetë e shtatë milionë e tridhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
**Eduart Seitaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS-VLORË (shtesa)" (faza e parë)

| Nr. | PRONARI | | | Z. kad. | Nr. i pasurisë | Sip. përgj m² | Sip. e shpronësuar m² | | | | | Sipërfaqe ndërtimi vlefta lekë/m² | Vlefta lekë/m² | Vlefta totale në lekë | Konfirmimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | emri | atësia | mbiemri | | | | sip. ndërtimi m² | truall m² | arë m² | ullishte m² | kullotë m² | | | | |
| 1 | B/P GUNBARDHI | | | 8605 | 6/146 | 8420 | | 1524 | | | | | 8300 | 12649200 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 2 | B/P AGALLIU | | | 8605 | 6/192 | 10158 | | 1887 | | | | | 8300 | 15662100 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 3 | B/P HOXHA, LICAJ | | | 8605 | 56/10 | 2000 | | | | 1464 | | | 281 | 411384 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 4 | B/P MERSINI, AGALLIU | | | 8605 | 56/85 | 13250 | | | | 5398 | | | 281 | 1516838 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 5 | B/P MASKAJ, DOLLANI, GEGA | | | 8602 | 44/207 | 1493172.15 | | 18026 | | | | | 10903 | 196537478 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 6 | LUAN | SELIM | FEIZAJ | 2074 | 373/28 | 1000 | | | 542 | | | | 204 | 110568 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 7 | AZEM | | SELMANAJ | 3140 | 183 | 21540 | | | 3741 | | | | 204 | 763164 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 8 | ZAMIR | | LIMO | 3140 | 137 | 700 | | | 700 | | | | 204 | 142800 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 9 | BASHKËPRONËSI | | | 3140 | 232/1 | 40000 | | | 2123 | | | | 204 | 433092 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 10 | OSMEN | | NUMANAJ | 3621 | 122/5 | 330 | | | | | 149 | | 165 | 24585 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 11 | B/P ISMAILI | | | 3621 | 234 | 87000 | | | | | 9443 | | 165 | 1558095 | Proces konfirmimi |
| 12 | JAZO | | BELULI | 3621 | 47/7 | 7000 | | | 952 | | | | 204 | 194208 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 13 | B/P RAMOHITO | | | 3621 | 120 | 10000 | | | 1875 | | | | 204 | 382500 | I pakonfirmuar |
| 14 | B/P TROQE | | | 3621 | 55/1 | 7000 | | | 1391 | | | | 204 | 283764 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 15 | B/P GJOHEMA | | | 3621 | 123/3 | 10500 | | | 71 | | | | 204 | 14484 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 16 | B/P BITRAJ | | | 3621 | 641/21 | 12000 | | | 62 | | | | 204 | 12648 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 17 | B/P MEHILLI | | | 2832 | 119/17 | 1913 | | | 1461 | | | | 204 | 298044 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 18 | EVELINA | | CARA | 2832 | 119/13 | 4000 | | | 1184 | | | | 204 | 241536 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 19 | IRMA | | SKËNDERI | 2832 | 119/14 | 5736 | | | 264 | | | | 204 | 53856 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| 20 | HYSNI | | DHIMA | 2832 | 182/10 | 5830 | | | 5 | | | | 204 | 1020 | Konfirmuar nga ZVRPP-ja |
| | **SHUMA** | | | | | **63979** | | | | | | | | **231291364** | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS-VLORË (shtesa) (faza e parë)

| Nr. | PRONARI | | | Z. kad | Nr. i pasurisë | Sip. përgj. $m^2$ | Sipërfaqe ndërtimi | | | Sipërfaqe truall | | | Vlefta totale në lekë | Konfirmimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | | | | Sip. ndërtimi $m^2$ | Sipërfaqe ndërtimi vlefta lekë/$m^2$ | Vlefta sipërfaqe ndërtimi | Truall sip. $m^2$ | Vlefta lekë/$m^2$ | Vlefta truall në lekë | | |
| 1 | ARBEN | RESUL | HAZIZAJ | 8605 | 6/273 | 84 | 84 | 60120 | 5050080 | 84 | 8300 | 697200 | 5747280 | Certifikatë pronësie |
| | **SHUMA** | | | | | | | | **5050080** | | | | **5747280** | |

## KËRKESË
## Nr. 1328, datë 15.3.2016

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Përmirësimi i shtresave rrugore Fushë-Krujë - Thumanë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit: "truall", "arë" dhe "objekt".

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit është 17 733 949 (shtatëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e nëntë) lekë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
**Eduart Seitaj**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

Lista e shpronesimit " PERMIRESIMI I SHTRESAVE RRUGORE FUSHEKRUJE-THUMANE"

| Nr. | Pronari Emri | Pronari Atesia | Pronari Mbiemri | Bashkia ose Fshati | Z.K | Nr.pas. | SIP. TOTAL | SIP ARE | SIP TRUALL | SIP. NDERTESE | SIP. Shpronesimi | Sip. PRONESI ARE | Sip. PRONESI NDERTESE | SIP E SHPRONESIMIT TRUALL | CMIMI ARE | CMIMI TRUALL | CMIMI NDERTES | VLERA TOTALE | KONFIRMIMET | SHENIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ISMET | RIZA | AHMETI | HASAN | 1934 | 26/13 | 22613 | 22613 | | | | 878 | | | 296 | | | 259888 | KONF. ZVRPP | |
| 2 | SELAM | IBRAHIM | SHALA | HASAN | 1934 | 21/47 | 2000 | | | 245 | 29 | | | 29 | | 312 | | 9048 | KONF. ZVRPP | |
| 3 | XHEMAL | MUAHARREM | GASHI | HASAN | 1934 | 8/13/1 | 1577 | 1577 | 730 | 94.1 | 13 | 13 | | | 296 | | | 3848 | KONF. ZVRPP | |
| 4 | FATMIR | MUAHARREM | GASHI | HASAN | 1934 | 8/31 | 5332 | 5332 | 452 | 207.2 | 72 | 72 | | | 296 | | | 21312 | KONF. ZVRPP | |
| 5 | ELIDA | NUE | SHKRETA | LUZ | 2537 | 68/44 | 2489 | 2489 | | | 32 | 32 | | | 253 | | | 8096 | KONF. ZVRPP | |
| 6 | GLADIOLA | NUE | MUSTEQJA | LUZ | 2537 | 68/42 | 2439 | 2439 | | | 351 | 351 | | | 253 | | | 88803 | KONF. ZVRPP | |
| 7 | LEONORA | NUE | LLESHI | LUZ | 2537 | 68/40 | 2399 | 2399 | | | 1031 | 1031 | | | 253 | | | 260843 | KONF. ZVRPP | |
| 8 | LEONORA | NUE | LLESHI | LUZ | 2537 | 68/38 | 2279 | 2279 | | | 1618 | 1618 | | | 253 | | | 409354 | KONF. ZVRPP | |
| 9 | MARIE | ZEF | MUSTEQJA | LUZ | 2537 | 68/36 | 2212 | 2212 | | | 540 | 540 | | | 253 | | | 136620 | KONF. ZVRPP | |
| 10 | KASTRIOT | ZEF | MUSTEQJA | LUZ | 2537 | 68/35 | 1305 | 1305 | | | 330 | 330 | | | 253 | | | 83490 | KONF. ZVRPP | |
| 11 | HAZIZ | | TMOVA | LUZ | 2537 | 27/1 | 7800 | 7800 | | | 16 | 16 | | | 253 | | | 4048 | KONF. ZVRPP | |
| 12 | VALENTIN | SHEFQET | SYMKALOVA | LUZ | 2537 | 4/19 | 4990 | 4990 | | | 315 | 315 | | | 253 | | | 79695 | KONF. ZVRPP | |
| 13 | VALENTIN | SHEFQET | SYMKALOVA | LUZ | 2537 | 4/20 | 3974 | 3974 | | | 14 | 14 | | | 253 | | | 3542 | KONF. ZVRPP | |
| 14 | NIKOLL | NDRE | BARDHOKU | DERVEN | 1475 | 54/1 | 6000 | 6000 | | | 95 | 95 | | | 391 | | | 37145 | KONF. ZVRPP | |
| 15 | TEREZE | TOM | SIMONI | DERVEN | 1475 | 54/2 | 1100 | 1100 | | | 89 | 89 | | | 391 | | | 34799 | KONF. ZVRPP | |
| 16 | TEREZE | TOM | SIMONI | DERVEN | 1475 | 54/12 | 4720 | 4720 | | | 58 | 58 | | | 391 | | | 22678 | KONF. ZVRPP | |
| 17 | EDMOND | GJIN | LULI | DERVEN | 1475 | 51/13 | 1655 | | 1655 | 141 | 4 | | | 4 | | 387 | | 1548 | KONF. ZVRPP | |
| 18 | PJETER | PASHK | BARDHOKU | DERVEN | 1475 | 51/8 | 1180 | 1180 | | | 281 | 281 | | | 391 | | | 109871 | KONF. ZVRPP | |
| 19 | AGIM | BAJRAM | KURTI | DERVEN | 1475 | 49/24 | 4236 | | 4236 | 890 | 168 | | | 166 | | 387 | | 64242 | KONF. ZVRPP | |
| 20 | GEG | ZEF | GJOKEJA | DERVEN | 1475 | 43/24 | 3696 | 3696 | | | 137 | 137 | | | 391 | | | 53567 | KONF. ZVRPP | |
| 21 | MHILL | ZEF | GJOKEJA | DERVEN | 1475 | 43/23 | 1550 | 1550 | | | 67 | 67 | | | 391 | | | 26197 | KONF. ZVRPP | |
| 22 | FRROK | ZEF | GJOKEJA | DERVEN | 1475 | 43/22 | 1502 | 1502 | | | 104 | 104 | | | 391 | | | 40664 | KONF. ZVRPP | |
| 23 | GJON | NDRE | LUFI | BORIZANE | 1247 | 350/3 | 5480 | 5480 | | | 836 | 836 | | | 343 | | | 286748 | KONF. ZVRPP | |
| 24 | MEHDI | BAJRAM | KURIT | BORIZANE | 1247 | 347/20 | 9050 | 9050 | | | 55 | 55 | | | 343 | | | 18865 | KONF. ZVRPP | |
| 25 | DEMIR | BERAM | KURTI | BORIZANE | 1247 | 347/4 | 6700 | 6700 | | | 11 | 11 | | | 343 | | | 3773 | KONF. ZVRPP | |
| 26 | ZENEL | TAHIR | VOGLI | BORIZANE | 1247 | 346/14 | 3250 | 3250 | | | 64 | 64 | | | 343 | | | 21952 | KONF. ZVRPP | |
| 27 | ISMAIL | BESIM | VOGLI | BORIZANE | 1247 | 343/3 | 7650 | 7650 | | | 651 | 651 | | | 343 | | | 223293 | KONF. ZVRPP | |
| 28 | SKENDER | SELMAN | VOGLI | BORIZANE | 1247 | 343/4 | 8480 | 8480 | | | 845 | 845 | | | 343 | | | 289835 | KONF. ZVRPP | SEKUESTRO |
| 29 | ALBERT | MYFTAR | VOGLI | BORIZANE | 1247 | 343/7 | 6280 | 6280 | | | 275 | 275 | | | 343 | | | 94325 | KONF. ZVRPP | |
| 30 | PRIVATE DOKU-P SH.P.K | | | BORIZANE | 1247 | 343/15 | 1600 | 1600 | | | 16 | 16 | | | 343 | | | 5488 | KONF. ZVRPP | SEKUESTRO |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 31 | ISA | MUHARREM | BALLA | BORIZANE | 1247 | 346/13 | 6700 | 6700 | | | 79 | 79 | | | 343 | | | 27097 | KONF. ZVRPP | |
| 32 | AGIM | AVDI | RRYTA | K-THUMANE | 2182 | 230/1 | 4335 | 4335 | | | 57 | 57 | | | 362 | | | 20634 | KONF. ZVRPP | KREDI |
| 33 | AGIM | IBRAHIM | FARRUKU | THUMANE | 3599 | 214/14 | 2700 | 2700 | | | 74 | 74 | | | 442 | | | 32708 | KONF. ZVRPP | |
| 34 | GANI | SEFULLA | FARRUKU | THUMANE | 3599 | 214/13 | 4900 | 4900 | | | 1451 | 1451 | | | 442 | | | 641342 | KONF. ZVRPP | |
| 35 | VATH | OSMAN | FARRUKU | THUMANE | 3599 | 214/2 | 1000 | 1000 | | | 1000 | 1000 | | | 442 | | | 442000 | KONF. ZVRPP | |
| 36 | OSMAN | MUSTAFA | FARRUKU | THUMANE | 3599 | 214/1 | 11900 | 11900 | | | 767 | 767 | | | 442 | | | 339014 | KONF. ZVRPP | |
| 37 | ALI | MUSTAFA | FARRUKU | THUMANE | 3599 | 214/10 | 5500 | 5500 | | | 102 | 102 | | | 442 | | | 45084 | KONF. ZVRPP | |
| 38 | AGIM | HYSEN | ISEDISHA | THUMANE | 3599 | 213/13 | 13000 | 13000 | | | 54 | 54 | | | 442 | | | 23868 | KONF. ZVRPP | |
| 39 | HAJRIE | AHMET | ZENELI | THUMANE | 3599 | 86/53 | 6100 | 6100 | | | 2238 | 2238 | | | 442 | | | 989196 | KONF. ZVRPP | |
| 40 | ARTUR | BESIM | LAMA | THUMANE | 3599 | 87/27 | 3000 | 3000 | | | 301 | 301 | | | 442 | | | 133042 | KONF. ZVRPP | |
| 41 | ARTUR | XHEMALI | JANGOZI | THUMANE | 3599 | 87/28 | 2063 | 2063 | | | 9 | 9 | | | 442 | | | 3978 | KONF. ZVRPP | |
| 42 | SEJFULLA | AHMET | FRESKU | THUMANE | 3599 | 87/25 | 6400 | 6400 | | | 390 | 390 | | | 442 | | | 172380 | KONF. ZVRPP | SEKUESTRO |
| 43 | PERPARIM | XHEKE | BUSHI | THUMANE | 3599 | 87/21 | 1860 | | 1207 | | 1860 | | | 1207 | | 442 | | 533494 | KONF. ZVRPP | |
| 44 | PERPARIM | XHEKE | BUSHI | THUMANE | 3599 | 87/21 | 116 | | | 116 | | | 116 | | | | | 11.277.102 | KARBURANT | LEJE NDERTIMI |
| 45 | GJIN | GJOK | MENGA | LUZ | 2537 | 4/24 | 4957 | | | | 125 | 125 | | | 253 | | | 31625 | KONF. ZVRPP | |
| 46 | ISMAIL | SUL | QIRA | BORIZANE | 1247 | 343/12 | 7000 | | | | | 366 | | | 343 | | | 125538 | KONF. ZVRPP | |
| 47 | LUAN | HASAN | KEQI | THUMANE | 3599 | 86/41 | 1244 | | | | 435 | 435 | | | 442 | | | 192270 | KONF. ZVRPP | NE PROCES SAKTESIMI |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | **17733949** | | |

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë